



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.577/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “MB Kurti” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr.REF-16011-06-01-2017, me objekt : “*Blerje Fadromë për Bashkinë Divjakë*”, me fond limit 2.500.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

Ankimues:

“MB Kurti” shpk
Lagjia “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iljaz Ahmeti”,magazinë 1 katëshe, pranë fabrikës së Qumështit.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Divjakë
Adresa: Lagjia nr. 2 Divjakë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

I. Në datën 02.06.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr.REF-16011-06-01-2017, me objekt : “*Blerje Fadromë për Bashkinë Divjakë*”, me fond limit 2.500.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.1. Në datën 12.06.22017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.2. II.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën 3154/1 prot. datë 07.07.2017 protokolluar me tonën me nr. 1197/2 datë 13.07.2017 me objekt “*Dërgim informacioni*”, rezulton se në datën 15.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Spektri” shpk	2.301.000	skualifikuar
- “AE Group” shpk	2.390.000	skualifikuar
- “Start & CO” shpk	2.400.000	skualifikuar
- “Klodjan Kajo” shpk	2.480.000	skualifikuar
- “MB Kurti” shpk	2.500.000	skualifikuar

II.3. Në datën 15.06.2017 operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Nuk ka paraqitur vertetimin për shlyerjen e taksave vendore nga Bashkia Korçë për vitet 2015,2016 .*
- *Nuk ploteson kriterin punë të ngjashme.*

II.4. Në datën 20.06.2017 operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

[...]

Shoqëria jonë analizoi me kujdes arsyetimin e AK-së dhe konkludojmë se skualifikimi është i padrejtë i pabazuar. Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se: Adresa Sekondare në Korçë ashtu sic përcaktohet në ekstraktin historik të QKB, është hapur më datën 07.02.2017 dhe rrjedhimisht shoqëria “MB Kurti” nuk ka pse të paguaj taksa vendore për vitet përpara hapjes së aktivitetit. Në përmbushje të kësaj pike kemi paraqitur vërtetim për taksat vendore për vitin 2015;2016;2017 nga Bashkia Lushnjë si dhe vërtetimin për taksat vendore për vitin 2017 nga Bashkia Maliq.

Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se: Në pikën 2.3 mbi kapacitetin teknik – përvoja e mëparshme kërkohet: Furnizime të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë në një vlerë jo me te madhe se 40 % e vleres se perlllogaritur te kontrates qe po prokurohet , të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit. Si deshmi per pervojen e mepareshme operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes ku shenohen datat, shumat , dhe sasite e mallrave te furnizuara .

Në përmbushje të kësaj pike kemi paraqitur kontratën nr. 2379/8prot., datë 20.08.2015 lidhur me posta Shqiptare sha me object: “Blerje pirun ngarkim shkarkimi”. Bashkëlidhur kontratës kemi paraqitur dhe faturën e shitjes së produktit. Kujtojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë produkte të ngjashme strikte sipas sasisë dhe grafikut të lëvrimit të dokumentave të procedurës pasi një gjë e tillë con drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të mallrave në kundësthim kjo me rregullat e prokurimit përcaktimit të zërave të njëjtë të mallrave në kundësthim kjo me rregullat e prokurimit public. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencia të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundësthim edhe me frymën dhe qëllimin e ligjit të prokurimeve publike të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar

konkurencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre oe-ve pjesmarrës në procedurat e prokurimit publik.

II.5 Në datën 27.06.2017 nëpërmjet shkresës nr. 2969/2prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën me argumentat e mëposhtme:

Autoriteti kontraktor ka sqaruar se:

[...]Skualifikimi i shoqërisë suaj për mungesën e plotësimit të kriterit punë të ngjashëm qëndron pasi puna e ngjashme e paraqitur nga shoqëria juaj është me objekt: “ Blerje pirun ngarkim – shkarkimi”, ndërkohë që objekti ynë i prokurimit është “Blerje fadromë për Bashkinë Divjakë”. Në lidhje me ankesën e bërë nga shoqëria juaj Autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë në përfundim të shqyrtimit të ankesës tuaj për procedurën e prokurimit me “Blerje fadromë për Bashkinë Divjakë”, vendosi: Ankesa juaj nuk është e bazuar në ligj dhe nuk e mori atë në konsideratë.[...]

II.6. Në datën 03.07.2017 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendimet si vijon:

[...]

Shoqëria jonë analizoi me kujdes arsyetimin e AK-së dhe konkludojmë se skualifikimi është i padrejtë i pabazuar. Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se: Adresa Sekondare në Korçë ashtu sic përcaktohet në ekstraktin historik të QKB, është hapur më datën 07.02.2017 dhe rrjedhimisht shoqëria “MB Kurti” nuk ka pse të paguaj taksa vendore për vitet përpara hapjes së aktivitetit. Në përmbushje të kësaj pike kemi paraqitur vërtetim për taksat vendore për vitin 2015;2016;2017 nga Bashkia Lushnjë si dhe vërtetimin për taksat vendore për vitin 2017 nga Bashkia Maliq.

Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se: Në pikën 2.3 mbi kapacitetin teknik – përvoja e mëparshme kërkohet: Furnizime të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet , të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit. Si deshmë për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes ku shenohen datat, shumat , dhe sasitë e mallrave të furnizuara .

Në përmbushje të kësaj pike kemi paraqitur kontratën nr. 2379/8prot., datë 20.08.2015 lidhur me posta Shqiptare sha me objekt: “Blerje pirun ngarkim shkarkimi”. Bashkëlidhur kontratës kemi paraqitur dhe faturën e shitjes së produktit. Kujtojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë produkte të ngjashme strikte sipas sasisë dhe grafikut të lëvrimit të dokumentave të procedurës pasi një gjë e tillë con drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të mallrave në kundësthim kjo me rregullat e prokurimit përcaktimit të zërave të njëjtë të mallrave në kundësthim kjo me rregullat e prokurimit public. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencën të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundësthim edhe me frymën dhe qëllimin e ligjit të prokurimeve publike të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre oe-ve pjesmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Shoqëria “ MB Kurti” shpk iu drejtua me ankesë AK-së më datën 20.06.2017 duke kundërshtuar vendimin e skualifikimit. AK-ja nëpërmjet shkresës 2969/2prot datë 27.06.2017 e refuzoi ankesën tonë duke i qëndruar pretendimit mbi punë të ngjashme. Në këto kushte duke qënë brenda afateve ligjore po i drejtohem KPP-së për të fituar të drejtën tonë. Përsa më sipër argumentuam kërkojmë pezul;limin e vazhdimit të procedurës së prokurimit derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht. Kualifikimin e ofertës tonë e cila plotëson të gjitha kushtet kualifikuese.[...]

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 3154/1 prot. datë 07.07.2017 protokolluar me tonën me nr. 1197/2 datë 13.07.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.pk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Nuk plotëson kriterin punë të ngjashme” Komisioni Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Pervoja e mëparshme*
 - a) *Furnizime të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet , të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit. Si dëshmi për pervojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes ku shenohen datat, shumat , dhe sasitë e mallrave të furnizuara .*
 - b) *Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat , si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku shenohen datat , shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara .*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “MB Kurti” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë me Posta Shqiptare sh.a dhe shoqërisë “MB Kurti” shpk nr. 2379/8prot, datë 20.08.2015 me objekt: “Për blerjen e Pirun Ngarkim Shkarkimi” me vlerë totale 1.587.600 lekë pa tvsh (e shoqëruar me akt marrjes në dorëzim datë 26.08.2015).*

- Kontratë me KESH sh.a dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rad Okej” shpk & “MB Kurti” shpk nr. 4679/8prot, datë 19.08.2015 me objekt: “Blerje Automjete për KESH sha” me vlerë totale 108.900.000 lekë pa tvsh (e shoqëruar me akt marrjes në dorëzim).
- Faturë tatimore shitje pirun ngarkim shkarkim me nr.serie 20498797, datë 21.08.2015

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 4 parashikohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.1.5. Referuar “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Neni 58, “Makina Teknologjike” pika 2 parashikohet se:

“1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma

specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.

2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat eknologjike ndahen në: a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;

b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;

c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve”.

[...]

III.1.6. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmërisë së tyre.

III.1.7. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë se kanë kryer furnizime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit. Në rastin konkret autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë një mall të vetëm i cili për nga natyra është specifik, i vecantë, për të cilin nuk mund të pretendohet se janë kryer furnizime të ngjashme kur me këtë të fundit nënkuptohet një makineri e një lloji tjetër nga ajo që kërkon të prokurojë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimes ka paraqitur një kontratë e cila ka për objekt të saj “Blerje pirun ngarkim shkarkimi”, ndërkohë që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë “Blerje Fadromë për Bashkinë Divjakë”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se furnizimi i kryer nga ankimesi nuk mund të konsiderohet i ngjashëm me mallin objekt prokurimi.

Nisur nga konstatimet sa më sipër operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk arrin të përmbushë kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimes “MB Kurti” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr.REF-16011-06-01-2017, me objekt : “ Blerje Fadromë për Bashkinë Divjakë”, me fond limit 2.500.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MB Kurti” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr.REF-16011-06-01-2017, me objekt : “ Blerje Fadromë për Bashkinë Divjakë”, me fond limit 2.500.000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1197 Prot; Datë 03.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha